



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 116 Prot

Tiranë, më 12, 07, 2012

**VENDIM Nr. 209, dt. 12.07.2012**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.07.2012 pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i HEC Prellë (Burrel) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "Prell Energy" sh.p.k., Dibër/Burrel,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "HEC Prellë (Burrel), paraqitur nga Subjekti "Prell Energy" sh.p.k., Dibër/Burrel.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Dibër bazuar në kontratën dypalëshe midis "Prell Energy" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("Prell Energy" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**  
*Bumçi*

**SEKRETAR I KKA**  
**ROLAND OLLI**

*R. Olli*

